Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Agnese Ibrahimi	**02.10.2023**	**13.10.2023**	**2023/0734**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 27.09.2023, OE “" Omega - I " SH.P.K”- Podujevë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0734, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE “" Liria SH.P.K”- Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizimi me rezervuar te naftes per ndertesat Qeveritare – ri-tender” me nr. të prokurimit: "214-23-8083-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 80,000 €.

Fazat e procedurës së prokurimit:
Njoftimi për kontratë: 01.08.2023
Hapja e Tenderëve: 24.08.2023
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 12.09.2023

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë nuk është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0734 i dt:27.09.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 - Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Duhet theksuar se AK "Ministria e Puneve te Brendshme" ne Vendimin e derguar me date: 20.09.2023 nuk e ka shqyrtuar – pergjigjur asnje prej pikave tona te pretenduara te Kerkeses per Rishqyrtim te cilin e kemi derguar me date: 14.09.2023.

Bazuar ne Njoftimin mbi vendimin e autoriteti kontraktues te publikuar me date: 12.09.2023, ne në emër te kompanisë tonë OMEGA-I sh.p.k. nuk kemi pranuar "Letër standarde për tenderuesin e eliminuar", Letra standarde e cila është dërguar është ne emër te një Operatori ekonomik tjetër.

Nëse kjo "Letër standarde për tenderuesin e eliminuar" është menduar për kompaninë tone

OMEGA –I sh.p.k. atëherë vendimi i komisionit vlerësues është i pa bazuar.

Arsyetimi mbi refuzimin e tenderit është si me poshtë:

Ju keni prezantuar listën e projekteve, mirëpo nuk keni asnjë projekt te ngjashëm ne listën e ofruar ashtu siç është kërkuar nga AK ne Njoftimi për Kontrate dhe Dosje te Tenderit, te gjitha projektet te cilat i keni prezantuar ne listën nuk kane te bëjnë asgjë me natyrën e prokurimit ne fjale.

Ne FTD te dosje se tenderit ne Kapaciteti teknik dhe professional është kërkuar

Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës së ngjashme gjate periudhës (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) minimumi një projekt të përfundur.

Arsyetimi se ne nuk kemi asnjë projekt te ngjashëm ne listën e ofruar është i pa bazuar, përderisa janë kërkuar furnizime te **ngjashme** dhe jo furnizime te njëjta, ne kemi listuar dhe ofruar dëshmi te mjaftueshme për furnizimi te ngjashme, si shembull mund te gjeni disa prej furnizimeve te ngjashme te cilat i kemi realizuar:

Komuna e Vushtrris - Furnizim me Gjeneratora - 18,300.00

Korporata Energjetike e Kosoves - Furnizim me pjes rezer per brenerat e mazutit - 23,741.60

Etj.

Andaj ne si OE jemi te përgjegjshëm me çmim me te ulet dhe i plotësojmë te gjithat kushtet e kërkuara sipas dosjes se tenderit.

Vlen të ceket po ashtu se çmimi i ofruar nga ana jonë është për **5,741.00 Euro** më i ulët se OE i rekomanduar për kontratë, AK është dashur të veproj në bazë të **Ligjit për Prokurimin Publik, Neni 1 Qëllimi, paragarfi 1,**

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla

dhe Neni 6 **Ekonomiciteti dhe Efikasiteti,** paragrafi **1**, ku**:**

Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Me date 13.09.2023 kemi kërkuar qasje ne dosje te tenderit te OE te rekomanduar për kontrate dhe na është mundësuar qasje me date: 13.09.2023.

Referenca e cila është konsideruar nga ana e AK-se që është e ngjashme

Referenca: Furnzime me rezervoar te naftës dhe Mazutit për nevojat e fabrikës se biberit, te cilën e ka prezantuar Liria sh,p,k, ne mes tyre dhe kompanisë private Ananas Impex, kemi vërejtur se nuk është paraqitur asnjë kontrate dhe ndonjë transfer bankar apo ndonjë dëshmi tjetër (evidentim te livrimit te tille) qe është realizuar projekti ne fjale ne mes tyre.

Bazuar ne **Ligjin e Prokurimin Publik,** për këtë rast AK është dashur qe te ketë parasysh **Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**

2.1. listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;

KRITERET PËR VLERËSIM

Kapaciteti teknik dhe professional **1. Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës së ngjashme gjate periudhës (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) minimumi një projekt të përfundur.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Lista e Furnizimeve te ngjajshme të realizuara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projekte e realizuara përfunduara në lëmin e furnizimeve të ngjashme, duke bashkëngjitur referenca ose qfardo deshmije që deshmon pranimin përfundimtar të furnizimeve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e furnizimeve (referencat duhet të jenë për kontratat e specifikuara në Listën e Kontratave).**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/Ministry of Internal Affairs

DATË/A:	20.09.2023
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	**Operatori Ekonomik-** OMEGA-I sh.p.k. Podujeve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	**e-prokurimit**
NGA/OD/FROM:	**Agim ISLAMI,** **Zëvendësues i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit -MPB**
TE MA/ SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim, për Aktivitetin e prokurimit, **'Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender'' Nr. i prokurimit 214-23-8083-1-2-1.**

Ministria e Punëve të Brendshme, duke vendosur sipas Kërkesave për Rishqyrtimi të Operatorit Ekonomik, **OMEGA-I sh.p.k. Podujeve,** të datës 14.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me Titull: **'Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender'' Nr. i prokurimit 214-214-23-8083-1-2-1,** kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien, të datës 12.09.2023 të publikuar në platformën elektronike, AK, mbështetur në Ligjit nr. *Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*, neni 108/A, (LPP) nxjerr këtë:

VENDIM

REFUZOHET Kërkesa për rishqyrtime e **Operatori Ekonomik OMEGA-I sh.p.k. Podujeve,** lidhur me aktivitetin e prokurimit **'Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender'' Nr. i prokurimit 214-214-23-8083-1-2-1.**

Autoriteti Kontraktues - MPB, për këtë aktivitet të prokurimit me procedurë të rregullt, ka publikuar Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien e aktivitetit të prokurimit, në sistemin elektronik E-prokurimi të KRPP-së me datën 12.09.2023.

PRETENDIMET ANKIMORE

Ligji i Prokurimit Publik (Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92 i datës 21 Janar 2016) dhe rregullave te prokurimit te nxjerra ne përputhshmëri me të.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Pretendimet e OE-së së AK ka ber shkelje të dispozitave ligjore si me poshtë:

Neni 1 - Qëllimi
Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

DEKLARATË DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET

Operatorët Ekonomik **Operatori Ekonomik OMEGA-I sh.p.k. Podujeve** si palë të pakënaqura kanë parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim tek AK me datën 14.09.2023, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie te aktivitetit te prokurimit, për tenderin me titull: **'"Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender" Nr. i prokurimit 214-214-23-8083-1-2-1,** duke pretenduar së janë bere shkelje, siç janë:

Bazuar ne Njoftimin mbi vendimin e autoriteti kontraktues te publikuar me date:
12.09.2023, ne në emër te kompanisë tonë OMEGA-I sh.p.k. nuk kemi pranuar "Letër standarde për tenderuesin e eliminuar", Letra standarde e cila është dërguar është ne emër te një Operatori ekonomik tjetër.
Nëse kjo "Letër standarde për tenderuesin e eliminuar" është menduar për kompaninë tone OMEGA –I sh.p.k. atëherë vendimi i komisionit vlerësues është i pa bazuar.
Arsyetimi mbi refuzimin e tenderit është si me poshtë:
Ju keni prezantuar listën e projekteve, mirëpo nuk keni asnjë projekt te ngjashëm ne listën e ofruar ashtu siç është kërkuar nga AK ne Njoftimi për Kontrate dhe Dosje te Tenderit, te gjitha projektet te cilat i keni prezantuar ne listën nuk kane te bëjnë asgjë me natyrën e prokurimit ne fjale.
Ne FTD te dosje se tenderit ne Kapaciteti teknik dhe professional është kërkuar
1. Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës së ngjashme gjate periudhës (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) minimumi një projekt të përfundur.
Arsyetimi se ne nuk kemi asnjë projekt te ngjashëm ne listën e ofruar është i pa bazuar, përderisa janë kërkuar furnizime te ngjashme dhe jo furnizime te njëjta, ne kemi listuar dhe ofruar dëshmi te mjaftueshme për furnizimi te ngjashme, si shembull mund te gjeni disa prej furnizimeve te ngjashme te cilat i kemi realizuar:
omuna e Vushtrris - Furnizim me Gjeneratora - 18,300.00
Korporata Energjetike e Kosoves - Furnizim me pjes rezer per brenerat e mazutit - 23,741.60
Etj.
Andaj ne si OE jemi te përgjegjshëm me çmim me te ulet dhe i plotësojmë te gjithat

kushtet e kërkuara sipas dosjes se tenderit.
Vlen të ceket po ashtu se çmimi i ofruar nga ana jonë është për 5,741.00 Euro më i ulët se OE i rekomanduar për kontratë, AK është dashur të veproj në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik, Neni 1 Qëllimi, paragarfi 1,
Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla
dhe Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, paragrafi 1, ku:
Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
Me date 13.09.2023 kemi kërkuar qasje ne dosje te tenderit te OE te rekomanduar për kontrate dhe na është mundësuar qasje me date: 13.09.2023.
Referenca e cila është konsideruar nga ju që është e ngjashme
Referenca: Furnzime me rezervoar te naftës dhe Mazutit për nevojat e fabrikës se biberit, te cilën e ka prezantuar Liria sh,p,k, ne mes tyre dhe kompanisë private Ananas Impex, kemi vërejtur se nuk është paraqitur asnjë kontrate dhe ndonjë transfer bankar apo ndonjë dëshmi tjetër (evidentim te livrimit te tille) qe është realizuar projekti ne fjale ne mes tyre.
Bazuar ne Ligjin e Prokurimin Publik, për këtë rast AK është dashur qe te ketë parasysh
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
2.1. listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;
Bazuar në kërkesën tone për rishqyrtim kërkojmë nga ana juaj të merrni këtë vendim
VENDIM
APROVOHET si e bazuar Kërkesa për rishqyrtim e OE "OMEGA-I. Sh.p.k."
ANULOHET Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të publikuar me datë: 12.09.2023, lënda të kthehet në rivlerësim dhe më pas të shpallet fitues OE "OMEGA-I sh.p.k."

Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP, pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore - **Operatorit Ekonomik OMEGA-I sh.p.k. Podujeve** Në zbatim të, *Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092* Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, nxjerrë këtë përfundim:

DEKLARATË DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET

Tenderuesi ankues Grup i Operatorëve Ekonomik **OMEGA-I sh.p.k. Podujeve** si pale e pakënaqur, në pretendimet e tij ankimore kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të publikuar në platformën elektronike e-prokurimi me datën 12/09/2023, për aktivitetin e prokurimit me Titull: "Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender" Nr. i prokurimit 214-214-23-8083-1-2-1, **KËRKESA PËR SHQYRTIM - i refuzohet e PA BAZUAR.**

Detale dhe argumente për pretendimet e neneve të shkelura dhe pikat ankimore për rishqyrtim të lartcekura nga OE, Autoritetin Kontraktues –Ministria e Punëve të Brendshme, konstaton së ka vepruar në harmoni të plot me LPP-në dhe nenet: **Neni 1 Qëllimi; Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; Neni 7. Barazia në Trajtim / Jo diskriminim,** ka trajtuar në mënyrë të barabar dhe pa diskriminim të gjithë OE ofertuese në harmoni të plotë me **Neni 59.** ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe **Nenin 40** të rregullores A01 Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik -së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, dhe në harmoni me LPP- në **Neni 60** Kriteret për Dhënien e Kontratës me kriteret e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit duke trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE-të. Kriteri për dhënie të kontratës oferta e përgjegjshme çmimi me i lirë dhe mbi këtë bazë AK-MPB ka trajtuar në mënyre të barabarta dhe pa diskriminim të gjithë OE-të në këtë AP.

Përgjigje në pretendimet Ankimore

Autoriteti kontraktuese -_Ministria e Punëve të Brendshme–ZPP dhe komisioni i vlerësimit ka vepruar në normoni të plotë me rregullativen ligjore mbi prokurimi publik në Republikën e Kosovës duke trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE-të palë në këtë proces.

Kapaciteti teknik dhe professional

1. Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës së ngjashme gjate periudhës (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) minimumi një projekt të përfunduar.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Lista e Furnizimeve te ngjashme të realizuara e nënshkruar dhe vulosur nga OE për projekte e realizuara përfunduara në lëmin e furnizimeve të ngjashme, duke bashkëngjitur referenca ose çfarëdo dëshmie që dëshmon pranimin përfundimtar të furnizimeve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e furnizimeve (referencat duhet të jenë për kontratat e specifikuara në Listën e Kontratave).

AK-MPB, ka veprua në harmoni të plotë me kërkesat e vendosura në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit ju keni dorëzuar listën e projekteve mirëpo nuk keni asnjë projekt të natyrës së ngjashme të përfunduara.

11. 09.06.2023 Cili është përkufizimi i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme" në kuptim të kontratave të realizuara në tri vitet e fundit?
Me LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë:

OPINION

Termi "njëjtë (i, e)" mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj.

Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme.

Në kuptim të prokurimit publik:

Termi " njëjtë (i, e)" ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës.

Termi "të ngjashme" ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Shembull: Lënda e Kontratës "Furnizim me mollë". Nëse AK kërkon si dëshmi " Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro". Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatoret ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së).

Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përshkruhet si në vijim: "Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara....." Pra, nuk përmendet asnjëri nga termet "të njëjta" apo "të ngjashme".

Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t'i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para.

Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: "Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në këtë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.

Gjithashtu AK ka vepruar në harmoni të plotë edhe me Vendimin e OPSH-së Nr. 0342/23 të datës 21/07/2023, pikërisht për pretendimin ankimorë të njëjtë për këtë AP.

Sqarojmë së për këtë aktivitet të prokurimit, object i prokurimit janë rezervuar një dhe dy shtresorë të lëndëve djegëse nga 250, 500, 1000, 5000, 10000 litra, të punuar sipas standardeve

ndërkombëtare EN1090

I. **3 - Kushtet teknike**

- Nga pozicioni 1.1 deri te pozicioni 1.3; rezervarët në formë cilindrike duhet të punohen sipas standardit Europian EN1090-2, EN12885-1 nga materiali S235JR dy shtresor ku duhet të llagaritet që mund të instalohen edhe nën Tokë;
- Rezervarët cilindrik duhet të kenë danca, lidhëse për instalimin e tyre;
- Nga pozicioni 1.4 deri te 1.7; rezervarët në formë ovale duhet të punohen sipas standardit Europian EN1090-2, EN12885-1 nga materiali S235JR një shtresor ku duhet të llagaritet që mund të instalohen edhe nën Tokë;
- Rezervarët oval duhet të kenë të instaluara daljet ¾ në të dy daljet mund të instalohet gypi i tejdukshëm për matjen e nivelit të naftës në formë fizike.

Dhe mbi këtë bazë ju nuk plotësoni kërkesat e AK-së.

Në zbatim të *Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092* Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, nxjerrë këtë përfundim:

Konkluzion:

I. REFUZOHET Kërkesa për rishqyrtim e Operatorëve Ekonomik **Operatori Ekonomik OMEGA-I sh.p.k. Podujeve** , të pa bazuara, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK për dhënie të tenderit nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, për tenderin **'"Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender" Nr. i prokurimit 214-214-23-8083-1-2-1..**

II. Mbetet në fuqi Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i publikuar me datën 12.09.2023 nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit për **'"Furnizimi me rezervuar të naftës për ndërtesat Qeveritare – ri-tender" Nr. i prokurimit 214-214-23-8083-1-2-1.**

III. Ministria e Punëve të Brendshme nga provat e prezantuara me lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

➢ **Këshille juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankese pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. 1 x 1 **OMEGA-I sh.p.k. Podujeve**
2. 1 x 1 e-prokurimit të MPB-ës.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

n/a

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" Omega - I " SH.P.K**

Sqarim hyrës: OE ankues ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, si palë e pakënaqur me vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku për kontratë është rekomanduar një OE tjetër. OE ankues ka ngritur disa pretendime të cilat eksperti shqyrtues do jap përgjigje si më poshtë.

Pretendimi 1

OE ankues pretendon se: *"Duhet theksuar se AK "Ministria e Puneve te Brendshme" ne Vendimin e derguar me date: 20.09.2023 nuk e ka shqyrtuar – pergjigjur asnje prej pikave tona te pretenduara te Kerkeses per Rishqyrtim te cilin e kemi derguar me date: 14.09.2023. Bazuar ne Njoftimin mbi vendimin e autoriteti kontraktues te publikuar me date: 12.09.2023, ne në emër te kompanisë tonë OMEGA-I sh.p.k. nuk kemi pranuar "Letër standarde për tenderuesin e eliminuar", Letra standarde e cila është dërguar është ne emër te një Operatori ekonomik tjetër. Nëse kjo "Letër standarde për tenderuesin e eliminuar" është menduar për kompaninë tone OMEGA –I sh.p.k. atëherë vendimi i komisionit vlerësues është i pa bazuar. Arsyetimi mbi refuzimin e tenderit është si me poshtë: Ju keni prezantuar listën e projekteve, mirëpo nuk keni asnjë projekt te ngjashëm ne listën e ofruar ashtu siç është kërkuar nga AK ne Njoftimi për Kontrate dhe Dosje te Tenderit, te gjitha projektet te cilat i keni prezantuar ne listën nuk kane te bëjnë asgjë me natyrën e prokurimit ne fjale. Ne FTD te dosje se tenderit ne Kapaciteti teknik dhe professional është kërkuar 1. Operatori ekonomik ose Grupi i Operatorëve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi së ka përfunduar me sukses furnizime të natyrës së ngjashme gjate periudhës (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) minimumi një projekt të përfundur. Arsyetimi se ne nuk kemi asnjë projekt te ngjashëm ne listën e ofruar është i pa bazuar, përderisa janë kërkuar furnizime te ngjashme dhe jo furnizime te njëjta, ne kemi listuar dhe ofruar dëshmi te mjaftueshme për furnizimi te ngjashme, si shembull mund te gjeni disa prej furnizimeve te ngjashme te cilat i kemi realizuar: Komuna e Vushtrris - Furnizim me Gjeneratora - 18,300.00 Korporata Energjetike e Kosoves - Furnizim me pjes rezer per brenerat e mazutit - 23,741.60 Etj. Andaj ne si OE jemi te përgjegjshëm me çmim me te ulet dhe i plotësojmë te gjithat kushtet e kërkuara sipas dosjes se tenderit."*

Sipas ekspertit shqyrtues duke u bazuar në kërkesat e Dosjes së Tenderit, është kërkuar që OE

të dorëzojnë kontrata të ngjashme me aktivitetin e prokurimit. OE ankues ka ofruar shumë kontrata por të cilat sipas mendimit të ekspertit nuk mund të konsiderohen si punë të ngjashme. Kontratat e cekura si "Furnizim me Gjeneratora" dhe "Furnizim me pjesë rezervë për brenerat e mazutit" nuk mund të konsiderohen si punë të ngjashme sepse janë shumë të ndryshme nga "*Furnizimi me rezervuar të naftës",* punë e ngjashme do kishte mundësi të trajtohej nëse kontrata e dytë do të kishte të bënte me Furnizim me rezervuarët e mazutit apo të ngjashme. Pra furnizimi me rezervuar nuk mund të konsiderohet si punë e ngjashme me furnizimin vetëm me pjesë rezervë, sepse kanë mjaft dallim. Andaj vlerësojmë që përderisa asnjëra nga kontratat e dorëzuara nuk i plotësojnë kriteret e DT-së, ky pretendim i ngritur është i pabazuar.

Pretendimi 2

"Me date 13.09.2023 kemi kërkuar qasje ne dosje te tenderit te OE te rekomanduar për kontrate dhe na është mundësuar qasje me date: 13.09.2023. Referenca e cila është konsideruar nga ana e AK-se që është e ngjashme Referenca: Furnzime me rezervoar te naftës dhe Mazutit për nevojat e fabrikës se biberit, te cilën e ka prezantuar Liria sh,p,k, ne mes tyre dhe kompanisë private Ananas Impex, kemi vërejtur se nuk është paraqitur asnjë kontrate dhe ndonjë transfer bankar apo ndonjë dëshmi tjetër (evidentim te livrimit te tille) qe është realizuar projekti ne fjale ne mes tyre."

Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar në ofertën e tij ka dorëzuar edhe kontrata të punëve të ngjashme sipas kërkesave të DT-së, ndër të tjerash kontrata më e përafërt të cilën e ka dorëzuar është "Furnzime me rezervuar të naftës dhe mazutit për nevojat e fabrikës së biberit", pretendimi i OE ankues se OE i rekomanduar nuk ka ofruar asnjë dëshmi për realizimin e kësaj kontrate nuk qëndron, sepse edhe sipas nenit 69 të LPP-së, por edhesipas kërkesës së DT-së është kërkuar që për listën e kontratave të dorëzuar, duhet bashkëngjitur referenca ose çfarëdo dëshmie që dëshmon pranimin përfundimtar të furnizimeve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e furnizimeve. Sipas kësaj kërkese, OE i rekomanduar ka dorëzuar referencë të lëshuar nga fabrika të cilën e ka furnizuar, përkatësisht një referencë të lëshuar nga Anans Impex shpk, e cila në mënyrë të detajuar cekë kontratën për të cilën është realizuar furnizimi, kohën, vendin dhe shumën e kësaj kontrate, edhe pse në kushte normale sipas LPP-së do të duhej të mbështetej edhe me ndonjë faturë e cila vërteton pagesën e realizuar, megjithatë përderisa një kërkesë e tillë nuk ka qenë e përfshirë në DT, atëherë sipas ekspertit nuk mund të dalim jashta këtyre kërkesave, sepse edhe një gjë të tillë e ndalon LPP. Andaj konsiderojmë se kjo kërkesë është përmbushur në tërësi nga OE i rekomanduar ashtu siç kanë qenë kërkesat nga Autoriteti Kontraktues, dhe se pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" Omega - I " SH.P.K**

Agnese Ibrahimi